

454  
28107110



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
VLORE



Nr.Akti 2031  
Dt,Regj.12.05. 2009

Nr.1470 Vendi  
Dt.Vend.24.06.2010

**V E N D I M**  
“ Në emër të Republikës”

Ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Vlore, sot ne date 24.06.2010trupi gjykues i perbere nga:

**Gjyqtari: Fuat MUKA**

e asistuar nga sekretarja e seances *Luljeta Kollombo* mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike çeshtjen civile Nr.2031 akti qe i perket paleve ndergjyqese :

**Paditese:**

Kristofor Kolagji i biri i Simon i dtl.1988 lindur e banues ne Vlore ne lagjen "Pavarsia", rruga "Sadik Zotaj" Vlore , perfaqesuar me deklarim nga Av.Luan Xhuveli .

**I paditur:**

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore – perfaqesuar nga Znj.Ina Puravelli e Znj Fabiola Pashaj .

**Objekti ;**

Detyrimin e pales se paditur te me njoh dhe te me hedhe ne sistem lendet mesimore te dhena ne Universitetin "Krital" Fier

**Baza Ligjore ;**

Neni 153 e vijues i K.Pr.Civile, Statusi dhe Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore .

Gjykata shqyrtoi aktet , administroi provat mbasi degjoi perfaqesuesin e paditesit qe ne perfundim te gjykimit kërkoi, pranimin e padise duke vendosur sipas objektit , perfaqesueset e pales se paditur qe kerkuan rrezimin e padise ,

si shqyrtoi çeshtjen në tërësinë e saj

Te njejtin vendim ka dhene komisjoni perkates i ketij Departamenti ne date 16.03.2010 per lendet " Histori i Institucionit te Shetitit " me noten 6 te vleresuar nga universiteti prej te cilit eshte trasferuar .

Por ndonese komisjonet perkatese kane vendosur ekujvalentimin e lendeve te pretenduara keto nuk jane future ne sistem per shkak te refuzimit te Rektorit te Univeresitetit "Ismail Qemali" Vlore , ne baze te kopetences qe i njeh si ligji 9741 date 21.05.2007 e statusi e rregullorja ne zbatim te ligjit .

Pala paditese ka kerkuar me shkresen e dates 31.03.2010 motivin e refuzimit per hedhjen ne sistem te notave lendet e pahedhura dhe pala e paditur me gjithë detyrimin ligjor per ti dhene pergjigje brenda afatit 30 ditor sipas Kodit te Procedures Administrative ende nuk e ka realizuar motivin e refuzimit .

Eshte kjo arsyeja pse pala paditese ka kerkuar detyrimin e pales se paditur Univeristetit " Ismail Qemali " Vlore ti njohe dhe te hedhe ne system ekujvalentimin e lendeve te permendura me larte , pretendim te cilin gjykata duke e gjetur te bazuar ne ligj dhe ne prova do ta pranoje .

Ne zbatim te nenit 39 te ligjit 9741 date 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republikes se Shqiperise" funksionin Statute i Universitetit "Ismail Qemali" Vlore , ashtu edhe rregullorja bashkangjitur Statutit , te miratura me vendimin e Senatit te Univeristetit "Ismail Qemali" date 12.09.2008 .

Ne nenin 22 te Statutit percaktohet se ;

"Univeristetit Ismail Qemali " Vlore mund te beje ekujvalentimin te pjeseve ose te programeve te plota te studimit ose diploma te marra ne institucionet e vendit ose te huaja ."

Po ne nenin 23 te Rregullores se miratuar nga Senati i Univeristetit Ismail Qemali " Vlore shprehimisht thuhet ;

"Per studentet qe duan te trassferohen ne Univeristetin Ismail Qemali " te Vlores , komisioni i ekujvalentimit i ngritur prane çdo departamenti mbi bazen e dokumentacionit qe dergon Universitetit perkates , percakton d etyrimet qae do te kete studneti , ne se pranohet ne ate dege sipas planit mesimor ne fuqi si dhe njohjen e shlyerjes se lendeve me ekujvalence ".

Ne rastin ne gjykim , veprimet e Komisioneve te Ekujvalentimeve te Departamentit te Drejtesise per sejcilen lende te pretenduar , jane realizuar ne vendimet e marra ne permbushje te si te rregullores ashtu dhe te statutit simbas nenit 23 e 22 te permendur me larte .

Ne lidhje me prapesimet e bera prej perfaqesueseve te Universitetit per mos hedhjen e lendeve te ekujvalentuara ne sistem, me arsyetimin se nuk njihen si te tilla nga Univeresiteti "Ismail Qemali" Vlore nuk qendron, mbasi ky univesiteti eshte autonomy dhe kjo autonomi rrjedh e funksionon nga ligji organik i arsimit te larte te permendur si me siper.

Ne nenin 3 te ketij ligji percaktohet liria dhe autonomia akademike e cila shprehet ne vete qeverisjen e tyre ne hartimet e programet e tjera. Kjo edhe per faktin se arsimi i Larte ne Republiken e Shqiperise ofrohet si nga persona juridik publike dhe ashtu edhe ata privat.

Dihet se Universitetit "Ismail Qemali" Vlore dhe Univeresiteti privat "Kristal" Fier nga ku eshte trasferuar paditesi jane te akredituara si institucione te Arsimit te Larte.

Ne sa me siper si njohja dhe ekujvalentimi i lendeve te pretenduara realisht jane realizuar nga struktura mesimore dhe pikersisht nga Komisionet perkatese te Departamentit te Drejtesise.

### PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne Neni 153 e vijues i K.Pr.Civile, Statusi dhe Rregullorja e Universitetit "Ismail Qemali" Vlore, ligji 9741 date 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte ne Republikes se Shqiperise".

### VENDOSI

1-Te pranoje padine e Kristofor Kolagji kunder Univeresitetit "Ismail Qemali" Vlore.

2-Te detyroje Univeresitetit "Ismail Qemali" Vlore te hedhe ne sistem si te ekujvalentuara nga student Kristofor Kolagji lendet e shlyera ne Univerisitetin "Kristal" Fier;


"Histori i Institucionit te Shetitit " nota 6, "E drejte Publike" nota 6, "E drejte Kushtetuese" - nota 8, "Llogjike" nota 5, dhe Gjuhe Angleze.

3. Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te paditurit.


Kunder ketij vendimi lejohetankim brenda 15 diteve nga dita e neserme e shpalljes se tij ne Gjykatën e Apelit Vlore.

U shpall ne Vlore ne dt.24.06.201

Sekretare  
Luljeta KOLLOMBO



GJYQATAR  
Fuat MUKA



## VEREN

Kristofor Kolagji me padine kunder Universitetit "Ismail Qemali" Vlore ka kerkuar detyrimin e ketij te fundit ne baze te ligjit 9471 date 21.05.2007 "Per Arsimine Larte ne Republiken e Shqiperise" si dhe Statusine Rregullores se Univerisitetit njohjen e hedhjen ne sistem lendet mesimore te dhena ne Univerisistemin "Kristal" te qytetit te Fier student i te cilit ka gene.

### Gjate gjykimit te ceshtjes ka rezultuar se ;

Kristofor Kolagji ne vitin akademik 2007-2008 ka filluar studimet ne Fakultetin e Drejtesise prane Univeresitetit privat "Kristal" te qytetit Fier. Ne respektim te parimit , afrimit te mundesive te trasferimit te studenteve midis programeve te te njejtit cikel , bazuar ne nenin 35 te ligjit 9741 date 21.05.2007 "Per Arsimin e Larte te Republikes se Shqiperise" i eshte mundesuar kalimi i ketij student nga universiteti privat "Kristal", per ne universitetin "Ismail Qemali " Vlore ku paditesi aktualisht vazhdon studimet .

Gjate studimeve ne vitin akademik 2007 - 2008 paditesi ka dhene mbi bazen e planit mesimor i'u eshte nenshtruar provimeve dhe pikerisht ne lendet ; " Histori i Institucionit te Shetitit " , " E drejte Publike" , " E drejte Kushtetuese" , " Llogjike " dhe Gjuhe Angleze, per te cilat notat perkatese te cilat perbejne edhe kredite e domosdoshme per perfundimin apo kalimin e vitit te pare akademik 2007-2008 .

Per shkak te vazhdimit te studimeve ne kete dege edhe vitin akademik 2009-2010 – paditesi ka kerkuar prane komisioneve perkatese te Ekuivalentimit te lendeve ; " Histori i Institucionit te Shetitit " , " E drejte Publike" , " E drejte Kushtetuese" , " Llogjike " dhe Gjuhe Angleze, dhe keto komisione kane vendosur ekujvalentimin e lendeve te pretenduara .

Ky fakt provohet vec thenieve te studentit ( ne rastin tone paditesi) dhe avokatit te tij , sikurse dhe me proces- verbalin e ekujvalentimit date 16.04.2009 , ku studentit Kristofor Kolagji lenda "Logjika" , i eshte ekujvalentuar me noten perkatese 5 .

Po me date 17.10.2010 Komisioni i Ekuivalentimit te Departamentit te Drejtesise ka vendosur ekujvalentimin e lendeve " E drejta Publike" e ate Kushtetuese , te studentit Kristofor Kolagji , me notat e paraqitura nga Fakulteti i Drejtesise dega Juridik i Universitetit " Kristal" Fier duke marre perkatesisht kreditet 6 e 8 .